

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, DKR, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët; Fillim Skoro kryetar, Have Haliti dhe Driton Muharremi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arta Dumani, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.M. nga fshati ..., komuna e Suharekës dhe A.M., nga Klina, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore –DKR në Gjilan, dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, F.M. dhe A.M., av. B.H. dhe av. S.R. të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës ThemeloreDKR në Gjilan, PKR.nr.77/17 të datës 19.05.2017, në seancën e kolegjit, me datë 17.08.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pa bazuara, ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, F.M. dhe A.M. ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.77/17 i datës 19.05.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin Gjykatës Themelore në Gjilan , PKR.nr.77/17 të datës 19.05.2017, të akuzuarit F.M. dhe A.M. janë shpallur fajtor për veprën penale blerje, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 KPRK-së, dhe janë dënuar me dënim me burgim me kohëzgjatje prej nga njëqindetëdhjetë (180) ditë, secili veç e veç, të cilin dënim duhet ta mbajnë në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e ekzekutimit të dhunshëm dhe dënim me gjobë në shumën prej nga 600 (gjashtëqind) euro, secili veç e veç, të cilin dënim në kuptim të nenit 46 par.2 të KPRK-së detyrohen që ta paguajnë në 3 këste të barabarta dhe atë nga 200 €, mirëpo nëse nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, atëherë dënimi i tillë iu zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, të cilin duhet ta fillojnë ta mbajnë me afat prej 15 ditësh. Në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së, të akuzuarve në dënimin me burgim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 16.03.2017 e deri me 19.05.20017. Në kuptim të nenit 69 lidhur me nenin 273 par.5 të KPRK-së , të akuzuarve i shqiptohet edhe dënimi plotësues duke iu konfiskuar substanca narkotike e llojit marihuan me peshë prej 1375.96 gram, e cila pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohet nga komisioni i posaçëm, nëse konform dispozitave ligjore. Gjykata e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e Prokurorisë Themelore në Gjilan lidhur me konfiskim e automjetit të markës S.A. me ngjyrë të zeze metalike, me numër të regjistrimit të tabelave 01-802-IS (e cila në momentin e sekuestrimit sipas raportit mbi automjetin e tërhequr me nr të rastit policor 2017 – DHTN – 160 i datës 17.03.2017 është konstatuar se ka pjesën e djathtë të dëmtuar para dhe pas si dhe gërvishje të vogla), pronar i të cilit është A.M. nga Klina. Urdhërohet sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale i Gjykatës se shkallës së parë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, automjetin lëndorë të ia kthej pronarit A.M. nga Klina, ashtu që procesverbalin lidhur me dorëzim t'ia bashkëngjis kësaj lënde penale.

Të akuzuarit gjykata i ka detyruar që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale, përkitazi me paushallin gjyqësorë edhe atë secili veç e veç në shumën prej nga njëqind (100) €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur :

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar ta ndryshohet, ashtu që të akuzuarve F.M. dhe A.M. të iu shqiptohet dënim me burgim dhe gjobë më i lartë, si dhe të konfiskohet automjeti.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M. av B.H., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshohet, të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me kusht, apo në rastin më të pavoritshëm në harmoni me nenin 47 të KPRK-së, dënimin e shqiptuar me burgim të i zëvendësohet me dënim me gjobë .

Mbrojtësit i të akuzuarit A.M., av. S.R., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me kusht, apo në rastin më të pavoritshëm në harmoni me nenin 47 të KPRK-së, dënimin e shqiptuar me burgim të i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën PPA.nr.323/17 të datës 12.07.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarve të shqiptohet dënime adekuate më të larta me dënim me burgim dhe me gjobë, kurse ndaj të akuzuarit A. ti shqiptohet edhe dënimi plotësues – konfiskimi i veturës S.A. me ngjyrë të zezë me targa 01 – 802-IS, ndërsa të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit në të murrën pjesë, i akuzuari F.M. dhe mbrojtësi i tij av. B.H., si dhe mbrojtësi i të akuzuarit A.M., av. S.R., kurse akuzuarit A.M.t dhe prokurori i apelit edhe pse kanë qenë të njoftuara me rregull nuk kanë marrë pjesë në seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, të mbrojtësve të akuzuarve të paraqitur në ankesë, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, sa për vendimi mbi dënimin dhe të konfiskimit automjeti të akuzuarit A.M.t, si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, janë të pabazuara.

Meqenëse aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve, për të cilat Gjykata e Apelit konform nenit 394 par1 të KPPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe konkret, në dispozitiv janë përshkruar veprimet inkriminuese të akuzuarve për veprën penale, nuk ka kundërthënie me arsyetimin e tij. Nga kjo del se nuk ka as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve, nga se përshkrimi faktik i dispozitivit i përmban të gjitha tiparet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 KPRK-së, për të cilën të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë.

Por as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi nga kjo gjykatë, se me ankesë aktgjykimi nuk ka mundur të ankimohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin fillestar e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, pas konsultimit me mbrojtësit e tyre, ku kryetari i trupi gjykues, është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo gjykatë e vlerësojë vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore, përkritazi me vendimin mbi dënimin.

Prokuroria në ankesë pretendon, se dënimi i shqiptuar nuk përkon me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarve, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve ka marr parasysh vetëm rrethanat lehtësuese, të cilat si të tilla nuk kanë mund të ndikojnë që dënimi të jetë aq i ulët, kur kihet parasysh natyra dhe llojin e veprës penale me karakteristikat përcjellëse, pasojat e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale, ku viktimat e këtyre veprave penale janë gjeneratat e reja, dukurin e rritjes së numrit të veprave penale të kësaj natyre, se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është tejet i ulët, më të cilin nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M., pretendon se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është tejet i ashpër, për faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, është mbajtës i familjes se prindi nuk i jeton, ka gjendje e varfër ekonomike, duke i pasur parasysh këto rrethana për të akuzuarin, ka vend që t'i shqiptohet një dënim me kusht, apo zëvendësim i dënimit me burgim me dënim me gjobë, me të cilin mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M. pretendon, se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është tejet i ashpër, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, është penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla penale, është i moshës se re dhe student i viti tretë në AAB, më parë nuk ka qenë i dënuar, qëndrimi në paraburgim në kohëzgjatje prej 62 ditë ka ndikuar në vetëdijesimin e të akuzuarit se ka kryer vepër penale të rrezikshme dhe ka ndikuar në arritjen e qëllimit të dënimit, ka propozuar që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë, apo dënimi i shqiptuar me burgim të i zëvendësohet me dënim me gjobë, me të cilin mund të arrihet qëllimi i shqiptimit të dënimit.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, kështu që të akuzuarve, si rrethana lehtësuese iu ka marrë për bazë pranimin e fajësisë, bashkëpunimin me organet hetuesisë duke treguar se kanë një sasi të substancës narkotike në shtëpinë e përbashkët të tyre, sjelljet korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, se janë penduar për veprën e kryer, më parë nuk kanë qenë të dënuar, i akuzuari F. është mbajtës i familjes sepse babanë nuk e ka në jetë, kurse i akuzuari A. është student, kurse si rrethana rënduese, i ka mare shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe nivelin në rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e përmendura ankimore si nga ana e prokurorisë, ashtu dhe nga ana e mbrojtësve të akuzuarit nuk qëndrojnë, nga se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, në mënyrë të drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat siç parashihen me dispozitat e nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Rrethanat lehtësuese që i ka marr parasysh gjykata e shkallës së parë për të akuzuarit me rastin e caktimit të dënimit, pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra tjera penale, i aprovon edhe kjo gjykatë, kurse mbrojtësit e të akuzuarve nuk

theksojnë ndonjë rrethanë konkrete lehtësuese, të cilat kishin me ndikuar që të akuzuarve të ju shqiptohet dënimi më i butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, prandaj pretendimi i mbrojtësve të akuzuarve se dënimi i shqiptuar është i ashpër dhe i prokurorisë se dënimi i shqiptuar është i butë, janë të pa bazuar, se gjykata e shkallës së parë në këtë rast ka aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit, duke ju shqiptuar dënim nën minimumin ligjor të paraparë për këtë vepër penale, bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Kurse pretendimet e prokurorisë rreth konfiskimit të veturës, janë të pa bazuara, se vetura nuk ka qenë objekt i kryerjes së veprës penale, se me rastin e kontrollimit të akuzuarve nga ana e policisë në xhepin e të akuzuarit F. është gjetur një cigare me marihuan dhe një qese e vogël në pallto, kurse sasia tjetër e substanca narkotike e llojit marihuan me peshë prej 1375.96 gram është gjetur në shtëpi, ashtu që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka vendosur që vetura të i kthehet të akuzuarit, se nuk është mjet me të cilën është kryer vepra penale.

Kjo gjykatë i aprovon rrethanën lehtësuese që ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit, që në veti përfshinë vetëdijesimin e të akuzuarve se kanë kryer një vepër të rrezikshmërisë së lartë shoqërore, pendimin e tyre për veprën e kryer, andaj kjo gjykatë gjënë se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është në proporcion me shkallën rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarave, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.335/17, të dt.17.08.2017

Procesmbajtësja,
Arta Dumani

Anëtarët e kolegjit
1.Have Haliti

Kryetare e kolegjit
Fillim Skoro

2..Driton Muharrremi